

Radio BBC, Shërbimi Shqip, 14 mars 2005

Intervistë me Kreun e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorin Pavel Vacek

Gazetare: Majlinda Zeqiri

Kur kanë mbetur rreth tre muaj nga mbajtja e zgjedhjeve të reja për parlamentin e Shqipërisë, ende mbeten disa çështje që presin zgjidhje, siç janë hartimi i listave të votuesve apo stërvitja e anëtarëve të komisioneve zgjedhore. Pak më parë, mes polemikash të shumta disamujore u kapërcye çështja e ndarjes së zonave. Të gjitha këto përgatitje dhe vetë hartimi i ndryshimeve rrënjësore në Kodin Zgjedhor të Shqipërisë janë kryer me ndihmën dhe ndërmjetësimin nga afër të pranisë së OSBE-së në Tiranë. Majldina Zeqiri e BBC-së intervistoi lidhur me këto zhvillime Ambasadorin e OSBE-së Pavel Vacek, duke e pyetur atë fillimisht nëse ishte i kënaqur me ecurinë e procesit të përgatitjes së zgjedhjeve.

Ambasadori Vacek: Kënaqësia është nocion relativ dhe, natyrisht, balanca e përgjithshme ka qenë e përzier. Ka pasur dështime, ka pasur vonesa, ka pasur ndërlikime politike, por nga ana tjetër ka pasur përparim drejt diçkaje që do të thotë zgjedhje më të mira dhe më të ndershme se më parë.

Z. Vacek, ju keni thënë se ndarja e zonave elektorale për të cilat u ra dakord pas mosmarrëveshjes së shumta tregon përparim, por megjithatë ajo nuk plotëson të gjitha kërkesat lidhore. Ç'do të thoni me këtë?

Ambasadori Vacek: Kërkesat ligjore shprehen qartë në Kodin Elektoral shqiptar, që pësoi disa ndryshime të reja më 10 janar të këtij viti. Ka disa kritere në Kodin Elektoral. Ka një që është kriteri numerik, që përcakton devijacionet e lejueshme në numrin e votuesve në zonat, me plus apo minus 10 për qind. Pastaj ka kritere të tjera, më të përcaktuara, që tregojnë se si duhet të jenë zonat. Duke folur për parametrat numerikë, këto janë tejkaluar në disa raste, duke pasur parasysh zgjidhjen për të cilën u ra dakord nga palët kryesore.

Z. Vacek, nuk ka ende lista të zgjedhësve. A mendoni se ka kohë të mjaftueshme që këto lista të jenë gati?

Ambasadori Vacek: Ka një kalendar të qartë të përgatitjes së listave të votuesve. Ai vetë realizohet. Çështja është nëse rezultati konkret i këtyre listave do të ketë cilësitë e duhura. Kjo ka më tepër të bëjë me teknikat e arritjes në listat e duhura të votuesve përse i përket cilësisë, se sa kohës së përgatitjes së tyre.

OSBE-ja dhe Përfaqësia e Bashkimit Evropian kanë bërë thirrje për veprime të shpejta për të qenë gati për zgjedhjet. A ka kohë të mjaftueshme?

Ambasadori Vacek: Vonesa sigurisht që ka pasur, por asnjë nga vonesat dhe ndërlikimet deri tani nuk kanë prekur përgatitjet në mënyrë fatale. Përgatitjet për zgjedhjeve janë brenda mundësive të autoriteteve që merren me zgjedhjet, qofshin këto Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ministria e Pushtetit Lokal, apo vetë bashkitë që merren me listat e votuesve.

Po përse i përket trajnimit të anëtarëve të komisioneve? Shpesh për to ka pasur kritika. Sa mund të ndikojnë këto në zgjedhjet?

Ambasadori Vacek: Trajnimi i anëtarëve të komisioneve elektorale është një nga çështjet më kritike, por ajo çka qenë çështje kritike dhe tensioni ka të bëjë me kriteret që lejojnë zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve pak para zgjedhjeve dhe kjo vetë është një vështirësi potenciale, pasi çështja qëndron në atë nëse këto kritere do të keqpërdoren apo jo. Dhe unë personalisht shpresoj që kjo gjë nuk ka për të ndodhur.

Z. Vacek, ka pasur vërejtje dhe kritika edhe në adresë të OSBE-së përsa i përket misionit ndërmjetësues të saj gjatë zgjedhjeve në Shqipëri. Si u përgjigjeni këtyre kritikave?

Ambasadori Vacek: Është e vështirë t'u përgjigjesh këtyre kritikave dhe akuzave. Ajo çka mund të them është se diçka është e qartë: roli ynë si ndërmjetësues është vetëm kur kërkohemi dhe duhet të jemi. Ne nuk e imponojmë rolin tonë. Përveç kësaj, ne kemi detyra konkrete të mandatuara. Por ndërmjetësimi në çështje politike është gjithmonë punë që nuk gjen mirënjohje. Është ky kushti për t'u përfshirë, por edhe tjetri: që duhet të ketë ndërmjetësim për një qëllim të caktuar, gjë që është në përputhje me misionin tonë në Shqipëri. Në rastin e zgjedhjeve dhe të reformës elektorale ky ndërmjetësim ka ndodhur në ato raste kur përndryshe do të kishim pasur bllokim, apo nuk do të kishim aspak përparim.